




REPUBLICA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK. Nr. 567/2023  
Datë: 27 dhjetor 2023

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 7, paragraf 1, pika 1.14, dhe 1.25, të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, duke shqyrtuar çështjen ndaj Ylber Shurdhiqi, gjyqtar në Departamentin e Përgjithshëm – Divizioni Civil në Gjykatën e Apelit, në vazhdimin e mbledhjes së 318-të, të mbajtur me datë 27 dhjetor 2023, nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. **Revokohet** vendimi i KGJK-së me numër KGJK.Nr.114/2022, i datës 10 mars 2022, për suspendimin e Ylber Shurdhiqi, gjyqtar në Departamentin e Përgjithshëm - Divizioni Civil i Gjykatës së Apelit.
- II. Paneli hetimor i themeluar me vendimin KGJK.nr.115/2022, i datës 10 mars 2022, njoftohet që të vazhdoj hetimin disiplinor në përputhje me nenin 9 të Ligjit Nr.06/L-057, për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, në qofte se rasti përmban elemente të shkeljes disiplinore.

## A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, ( me tutje si “KGJK”) me datë 10 mars 2022, ka mbajtur takimin e 280-të, në të cilën ka shqyrtuar kërkesën e Autoriteti Kompetent për fillimin e hetimeve disiplinore ndaj Ylber Shurdhiqi, gjyqtar në Departamentin e Përgjithshëm-Divizioni Civil i Gjykatës së Apelit më ç’rast është themeluar panelit hetimor për të hetuar shkeljen e supozuar disiplinore.

Me tutje, KGJK në kuptim të dispozitës se nenit 2, të Ligjit Nr.08/L-003 për Plotësimin dhe Ndryshimin të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ku përcaktuar se “Gjatë procedurës hetimore, Këshilli ex officio ose me kërkesë të Autoritetit Kompetent i cili ka kërkuar fillimin e hetimeve disiplinore, mund të suspendoj gjyqtarin ose prokurorin i cili është nën hetime nëse një gjë e tillë është e nevojshme duke marrë parasysh seriozitetin e shkeljes disiplinore të supozuar disiplinore dhe të sigurohet integriteti dhe efektiviteti i hetimeve”, sipas detyrës zyrtare e ka shqyrtuar dhe ka vlerësuar çështjen e suspendimit të gjyqtarit në fjalë dhe sipas diskutimeve në mënyrë unanime ka vendosur për suspendimi e gjyqtarit me datë 10 mars 2022.

Në përputhje me nenin 11, të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, KGJK me datë 10.03.2022, sipas detyrës zyrtare i ka dërguar Prokurorisë Themelore në Prishtinë, lëndën PP.I.26K/22 të kompletuar me provat, të pranuar nga ankuesi M.M, me datë 21.02.2022, kundër gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Ylber Shurdhiqi, lidhur me dyshimet për kryerje të veprimeve korruptive gjatë ushtrimit të autorizimeve të tij si gjyqtar.

Me datë 26 dhjetor 2023, KGJK ka pranuar nga Prokuroria Speciale raportin për mbylljen e rastit të evidentuar PPN.nr.69/2022, e iniciuar në Prokurorinë e Shtetit nga KGJK-ja sipas ankesës së personit M.M, kundër të dyshuarit Ylber Shurdhiqi, gjyqtar i Gjykatës së Apelit, për shkak se nuk ekziston dyshimi i bazuar se është kryer veprë penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare.

Pas pranimit të raportit nga Prokuroria Speciale, KGJK në mbledhjen e mbajtur me datë 27 dhjetor 2023, e shqyrtoj të njëjtin dhe vendosi të revokoj vendimin e KGJK-së të evidentuar KGJK.nr.114/2022, të datës 10 mars 2022, për suspendimin e gjyqtarit Ylber Shurdhiqi. KGJK vendosi për revokim të vendimit për suspendim, për shkak se suspendimi ishte caktuar nga shkakun që gjyqtari në veprimet e tija mund të ketë konsumuar elemente të veprës penale, andaj në këtë rast pas konfirmimit që gjyqtari nuk është përfshirë në veprë penale, suspendimi i të njëjtit vlerësohet se nuk është i nevojshëm.

Sipas vlerësimit të KGJK-së, paneli hetimor i themeluar me vendimin KGJK.nr.115/2022, i datës 10 mars 2022, do të vazhdoj hetimin disiplinor në përputhje me nenin 9, të Ligjit Nr.06/L-057, për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, në qofte se rasti përmban elemente të shkeljes disiplinore dhe ti dorëzoj KGJK-së raportin mbi faktet dhe provat e mbledhura.

Nga se u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës  
KGJK.nr.567/2023, datë: 27 dhjetor 2023

Albert ZOGAJ,

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



*Kopje e vendimit i dërgohet:*

- Valon Totaj, Kryetar, Gjykata e Apelit;
- Ylber Shurdhiqi, Gjyqtar, Gjykata e Apeli;
- Panelit Hetimor.